

MENDIM PAKICE

Me vendimin nr. 19, datë 15.05.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor (KZGJ) vendosi të rrëzojë padinë e paraqitur nga **Bashkia Shijak**, përfaqësuar nga z. Elton Arbana, me të cilën kundërshtohet vendimi i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) nr.84, datë 08.05.2023.

Në cilësinë e gjyqtarëve të caktuar në përbërje të trupit gjykues, parashtrohet mendimi i kundërt me vendimin e shumicës që pranoi në kompetencë të KZGJ-së, çështjen objekt shqyrtimi. Gjyqtaret në pakicë ndajnë mendimin se mosmarrëveshja është në kompetencën lëndore të gjykatës administrative.

Referuar shkakut të padisë, rezulton se Kryetari aktual i Bashkisë Shijak, z. Elton Arbana si subjekt zgjedhor i regjistruar pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, duke rikandiduar për kryetar të Bashkisë Shijak **(edhe të tjerë)** është proceduar administrativisht për shkelje të detyrimeve që burojnë nga ligji, lidhur me ndalimin e postimeve me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të bashkive respektive, të cilat përbëjnë përdorim të burimeve publike. *(Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet raportit të KRIIK, të datës 24 Prill 2023, "Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 14 Prill- 20 Prill 2023")*.

Në vijim pretendohet se: *Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore prej nisjes së periudhës katërmujore më datë 13 Janar 2023, ashtu si dhe më parë, e deri më sot, në një pjesë të konsiderueshme të Faqeve Zyrtare në Facebook të Bashkive të vendit janë përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve (#) e konkretisht për rastin në fjalë: (nr. 20). ... Në faqen zyrtare të Bashkisë Shijak është përdorur hashtag #ShqipëriaEardhmjaJonë;#SkaKohëPërPushim.*

Pas caktimit të dënimit administrativ nga KAS, u ngrit padia objekt gjykimi. Lidhur me këtë mosmarrëveshje, vlerësohet të parashtrohet se Kodi Zgjedhor (ligji nr.10019 datë 28.12.2008, i ndryshuar) sipas nenit 1 të tij, ka synim përcaktimin e rregullave lidhur me përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë. Përmes këtyre rregullave, synohet të garantohet zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Në referencë të rregullave të parashikuara në Kodin Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është pikërisht institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve dhe ndër të tjera zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor.

Në nenin 12 dhe vijues të Kodit Zgjedhor, janë evidentuar dhe rregulluar mënyra e funksionimit dhe kompetencat përkatëse të organeve drejtuese të KQZ-së, konkretisht Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Ndër të

tjera, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve konsiderohet sipas Kodit Zgjedhor, organi kompetent për shqyrtimin e ankimimeve administrative dhe për vendosje të sanksioneve përkatëse për shkelje të ligjit zgjedhor.

Kodi Zgjedhor, në pjesën XIII ku parashikohen PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONE, dhe konkretisht në nenin 172 me titull “**Sanksionet për subjektin zgjedhor për shkelje të ndalimeve të këtij ligji**” (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020) parashikon se: 1. Subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen **shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji** dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijeni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja administrative sipas kësaj pike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë. 2. Masa e gjobës përcaktohet në varësi nga rrethanat e mëposhtme: a) rreziku që përbën shkelja për zhvillimin dhe administrimin e zgjedhjeve në të ardhmen; b) fakti nëse autori i shkeljes është anëtar ose i punësuar nga subjekti zgjedhor; c) kohëzgjatja dhe rrethi i veprimeve që kanë çuar në kryerjen e shkeljes; ç) fakti nëse ka pasur përpjekje për fshehjen e shkeljes nga ana e subjektit zgjedhordhe në ç’shcallë kanë qenë ato; d) veprimet e subjektit zgjedhor pas zbulimit të shkeljes; dh) fakti nëse në kryerjen e shkeljes kanë marrë pjesë persona zyrtarë ose janëshfrytëzuar burime publike; e) fakti nëse shkelja është përsëritur; ë) fakti nëse është kryer në bashkëpunim; f) rreziku potencial ndaj zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente. 3. Gjjobat, sipas pikës 1 të këtij neni, vihen nga KQZ-ja. 4. Shkeljet, sipas pikës 1 të këtij neni, kur kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 2 vjet.”

Nisur nga sa më sipër, shtrohet për diskutim çështja nëse vendimet e KQZ-së për konstatimin dhe ndëshkimin e një kundërvajtje administrative në fushën zgjedhore, janë apo jo në lëndën e mosmarrëveshjeve që shqyrtohen nga KZGJ, apo ankimet kundër vendimeve për këto kundërvajtje administrative, do të ndjekin rrugën e zakonshme të gjyqimit administrative?

Paraprakisht evidentohet fakti se, në mjaft raste të praktikës së mëparshme të Kolegjit Zgjedhor, ky i fundit ka mbajtur qëndrimin se kundërvajtjet administrative dhe mosmarrëveshjet që lindin për shkak të tyre, në kuadër të zbatimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor, janë në kompetencë të gjykatës administrative.

Ky qëndrim i KZGJ-së, i referohet së pari natyrës së posaçme të gjykatës së zgjedhjeve, e krijuar nga ligji me qëllim shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, që lindin përgjatë një procesi zgjedhor (zgjedhje për Kuvendin, ato vendore apo referendumet). Është kjo arsyeja për të cilën, KZGJ mbledhet jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve dhe qëndron i mbledhur deri në përfundim të gjyqimit të ankimeve ose të kalimit të afatit të ankimeve për procesin zgjedhor, sikurse mbledhet 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme dhe referendumet dhe qëndron po ashtu i mbledhur deri në përfundim të shqyrtimit të ankimeve për këto procese (shih nenin 147 të Kodit Zgjedhor).

Vetë struktura e Kodit Zgjedhor tregon se objekt i ankimeve gjyqësore në KZGJ do të jenë ato çështje, që shqyrtohen fillimisht sipas Pjesës X të Kodit Zgjedhor titulluar “*Ankimi në rrugë administrative i vendimeve të komisioneve zgjedhore*”. Është pikërisht kjo pjesë e Kodit Zgjedhor që trajton ankimet zgjedhore, ngritjen e një regjistri të posaçëm për to, formën dhe përmbajtjen e ankimit zgjedhor, rregullat procedurale për shqyrtimin administrativ dhe vendimin që merret në përfundim të procesit.

Pas pjesës X të Kodit Zgjedhor vjen Pjesa XI, që rregullon ankimet në rrugë gjyqësore të vendimeve të KQZ-së dhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Nga përmbajtja e Kreut I të kësaj pjese, si dhe në lidhje logjike me Kreun X, qartazi kuptohet se në fushën e kompetencës së KZGJ-së, bëjnë pjesë vetëm ankimet gjyqësore, kundër vendimeve të KQZ-së që lidhen me procesin zgjedhor përkatës dhe të referuara nga subjektet e posaçme. Kështu, Kodi Zgjedhor përcakton, njëjtë sikurse edhe në rastin e ankimit administrativ ndaj vendimeve të komisioneve zgjedhore (neni 124 i Pjesës X), se subjektet që legjitimohen të paraqesin ankimet e tyre në KZGJ janë : 1) subjektet zgjedhore; 2) partitë politike ose kandidatët e mbështetur nga zgjedhësit që paraqesin kërkesë për t’u regjistruar si subjekte zgjedhore; 3) subjektet që kërkojnë të akreditohen si vëzhgues në zgjedhje, kur i’u refuzohet një gjë e tillë. Nga ana tjetër, kompetenca e KAS për vendosjen e sanksioneve administrative, nuk është rrjedhojë e një procesi ankimimi, por ushtrim i kompetencës së caktuar me ligj për të shqyrtuar nëse një kundërvajtje është kryer apo jo, si dhe për të vendosur ndëshkimin përkatës.

Nisur nga sa më sipër, KZGJ edhe në rastet e tjera të ngjashme kur i janë paraqitur ankime gjyqësore ndaj vendimeve që konstatojnë dhe ndëshkojnë kundërvajtje administrative, të kryera këto edhe nga subjekte, që e kanë mbajtur cilësinë e subjektit zgjedhor, nuk i ka konsideruar në fushën e tij të kompetencës.

Kompetencat e KZGJ-së jo vetëm që nuk përfshijnë shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lidhen me kundërvajtjet e kryera sipas Kodit Zgjedhor, por KZGJ nuk shqyrton as çështje që kanë ndikim në vijimësinë e një mandati të fituar në zgjedhje, siç janë rastet e vendimeve të KQZ-së për pavlefshmërinë e mandatit të të zgjedhurve, që kanë impakt të drejtpërdrejtë në listat e kandidimit, me të cilat një subjekt zgjedhor ka marrë pjesë në zgjedhje. Në një prej rasteve kur është vënë në diskutim çështja e kompetencës lëndore mes gjykatës administrative dhe Kolegjit Zgjedhor, ndërsa gjykata administrative arsyetonte se janë në kompetencë të Kolegjit Zgjedhor të gjitha vendimet e KQZ-së që cenojnë të drejtat e subjekteve zgjedhore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, e gjeti të pabazuar këtë qëndrim (shih vendimin nr. 667, datë 08.05.2018 të Gjykatës së Lartë). Ndër të tjera, Kolegji Administrativ arsyeton se:

“... Një nga kategoritë e mosmarrëveshjeve administrative që ligjvënësi e ka përjashtuar nga fusha e shqyrtimit të gjykatave administrative janë ato që burojnë nga vendimmarrja e Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve në kuadër të procesit zgjedhor. Mbështetur në analizën e bërë më sipër kompetenca lëndore e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë, shtrihet vetëm për mosmarrëveshjet që lindin nga procesi zgjedhor (kundërshtimi i vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me administrimin e procesit zgjedhor). Asnjë mosmarrëveshje tjetër, qoftë edhe kur buron nga vendimmarrja e këtij organi publik (Komisionit Qendror të Zgjedhjeve), por jo në kuadër të procesit zgjedhor, nuk mund t'i atribuohet kompetencës lëndore të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë. Pra, kompetenca e saj, duke qenë ekskluzive, duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë dhe fokusohet vetëm në mosmarrëveshjet zgjedhore, të ngritura nga subjektet zgjedhore. ...”

Nisur nga sa më sipër, në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, që kufizojnë kompetencën e KZGJ-së vetëm në shqyrtimin e ankimeve, lidhur me procesin zgjedhor, arrihet në përfundimin se çdo mosmarrëveshje tjetër e KQZ-së, që nuk lidhet me këtë proces, por me ushtrimin e funksioneve publike të ngarkuara me këtë Kod dhe me ligje të tjera të veçanta, nuk bëjnë pjesë në fushën e kompetencës së kësaj gjykate, por duhet të ankimohen në rrugën e zakonshme në gjykatën administrative.

Si përfundim, jemi të mendimit se çështja e paraqitur nga **Bashkia Shijak**, përfaqësuar nga z.Elton Arbana, me të cilën kundërshtohet vendimi i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) nr. 84, datë 08.05.2023, me objekt kundërshtimin e sanksionit administrativ, të caktuar nga KAS, duhej të ishte pushuar dhe aktet t'i dërgoheshin për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila do verifikonte edhe legjitimitetin e paditësit.

Tiranë, 15.05.2023

GJYQTARE

EMONA MUÇI

GJYQTARE

EDLIRA PETRI